



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Datë 26.06.2023

Numri i vrojtimit i lejes:

07Nr.516/350-27685

Në bazë të nenit 21 të LPH nr.04/L-174 datë 31.07.2013, nenit 18 të LN nr.04/L-110 datë 31.05.2012, neni 13 paragrafi 4 pika 2 i UA-06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për Kushte ndërtimore, Leje ndërtimore dhe Leje rrënimi për kategorinë e I dhe të II të ndërtimeve, UA Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor datë 09.06.2017, Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, si dhe neneve 44,47,48 dhe 125 të LPPA nr.05/L-031, DUP në Suharekë lëshon këtë:

AKTVENDIM

(MBI LEJEN NDËRTIMORE-OBJEKT BANIMI INDIVIDUAL)

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	OSMAN Xheladin KOLGECI, Rr."7 Shtatori" Suharekë	Adresa:	Rr."7 Shtatori" Suharekë
Email:	/	Kërkesa Bazë:	Aplikim për Leje ndërtimore: 07Nr.350-27685 datë 28.04.2023
Emri i Projektit:	PROJEKTI ARKITEKTONIK B+ P+1		
Emri i Projektuesit:	"Geo Limit" SH.P.K Prishtinë		
Adresa:	Z2-S2 Lakrishte Llamell 1 -000-12, Prishtinë		
Emaili:			
Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI-OBJEKT SHTEPI INDIVIDUALE			
Adresa: Rruga "7 Shtatori", Suharekë			
Zona(t) Kadastrale: Suharekë	Nr.i parc. kadastrale:	Koordinatat e objektit:	
Me numër referues të certifikatës 1896/2023 datë 27.04.2023 pronë e Osman Xheladin Kolgemit nga Suhareka	00856-5 , 00856-6	Y= 7485660.651 Y=7485655.259 Y=7485654.262 Y=7485645.261 Y=7485644.758 Y=7485642.506 Y=7485643.009 Y=7485639.680 Y=7485642.790 Y=7485641.644 Y=7485643.074 Y=7485645.902 Y=7485647.763	X=4691825.029 X=4691809.707 X=4691806.875 X=4691810.043 X=4691808.614 X=4691809.406 X=4691810.835 X=4691812.006 X=4691820.843 X=4691821.246 X=4691825.310 X=4691824.279 X=4691829.564
Lloji i ndërtimit të propozuar:			
Objekt Individual			

Kategoria e ndërtimeve të propozuara:

Kategoria II

Sipërfaqja e përgjithshme Bruto e Objektivit:

797.28m²

Përshkrimi

Me këtë vendim, poseduesit të Lejës ndërtimore Osman Xheladin Kolgeci nga Suhareka i lejohet ndërtimi i Objektivit individual banimi me etazhitet P+1 duke mos e tejkalar koeficientin e ndërtimit dhe kushtet tjera të definuara me Hartën Zonale të Komunës, Kushteve ndërtimore dhe Udhëzimeve Administrative.

Lokacioni i objektivit është në kuadër të HZK-së 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, konkretisht në Lagjën Pojata të Suharekës, ku sipas gjendjes së planifikuar parcelat kadastrale 0856-5 dhe 00856-6 ZK Suharekë është tokë ndërtimore me destinim Sipërfaqe Sub Urbane – ZB3 (Zonë e banimit me një njësi). Objekti do të ndërtohet sipas projektit të hartuar nga byroja projektuese: "GEO LIMIT" Sh.p.k, Prishtinë.

Objekti ka karakter të përhershëm me etazhitet B+P+1. Ndërtimi i objektivit të bëhet konform Kushteve Ndërtimore të lëshuara nga ky organ: 07Nr.127/350-9278 datë 28.02.2023

Objekti është lejuar të ndërtohet me sipërfaqe në përdhese: 296.94m²

Kjo Leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse (të ofruara nga ana e palës gjatë tërë procesit të shqyrtimit të saj). Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet teknike dhe juridike të aprovuara për ndërtim të objektivit. Çfarëdo ndryshimi i projektit kryesor duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

Poseduesi i Lejës Ndërtimore është i obliguar që:

- Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj Leje Ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.
- Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejën Ndërtimore, Projektuesin, Kontraktuesin dhe Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.
- Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj Leje ndërtimore;
 - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të Lejes ndërtimore dhe kontraktuesit;
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
 - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarine ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur;
 - Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit në shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore.
 - Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejës Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;

- Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
- Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
- Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njejtin ta transportojë në deponinë për trajtimin e tyre, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

Arsyetim

Aplikuesi nga Suhareka, Z.Osman Xheladin Kolgeci, përmes kërkesës 07Nr.350-27685 datë 28.04.2023 ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtim të objektit me destinim Objektit individual arkitektonik B+P+1, sipas projektit të bashkangjitur. Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Aktvendimi mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr. 127/350-9278 datë 28.02.2023(kopje),
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.64/23 datë 22.03.2023, lëshuar nga Kompania Regjionale për Mbeturina "EKOREGJIONI" SH.A. Prizren, Njësia Operative – Suharekë,
- Pëlqim nga kompania Rajonale e Ujësellsit "Hidroregjioni Jugor" për kyqje në ujsjellsin e qytetit lëshuar nga KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A.Prizren Nr.231 datë 22.03.2023.
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor–nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09Nr.132 datë 08.06.2023,
- Pëlqim parimor për rregullim të dokumentacionit teknik, KEDS-SH.A, Nr.242 datë 28.03.2023,
- Kontratë për konstituimin e përhershëm të kalimit Nr.LRP.6903/2023, Nr.i ref.1867/2023 datë 13.06.2023.
- Tri kopje të projektit zbatues dhe një kopje elektronike,
- Kopje e planit dhe certifikata e pronësisë,
- Koordinatat e vendosjes së Objektit të projektuar sipas gjeodetit të Komunës Atdhe Buzhala.
- Kopje e dokumentit Identifikues,
- Dëshmi për pagesën e taksës sipas njoftimit 07Nr.461/350-27685 datë 19.06.2023, taksa administrative 2232.37€ dhe taksa e Infrastruktues 889.70€, gjithësej në shumë prej 3122.07€, e paguar në TEB SH.A me datë 19.06.2023, sipas faturës komunale nr.001129 datë 19.06.2023.
- Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr.04/L-110, konform Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022 ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtimin e objektit, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MMPHI-sënë Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Komuna Suharekë

Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.516/350-27685 datë 26.06.2023

Vendimi i dërgohet:-Parashtruesit të kërkesës; Inspektoratit të Komunës; Dosjes së DUP-së

Drejtori i Drejtorisë:
Visar KUÇI

